



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.01.2020, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Dekret i Presidentit nr. 11414, datë 11.01.2020 “Për kthimin për shqyrtim të ligjit nr. 92/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Robert Bitri, Andrea Marto, Ilir Ndraxhi, Eglantina Gjermani, Gjetan Gjetani, Ardit Konomi, Tatiana Nurçe, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Nimet Musaj, Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama, Edmond Leka dhe Zef Shtjefni.

Mungojnë:

Lefter Koka dhe Rrahman Raja.

Të ftuar:

Bledar Dervishaj - Këshilltar Ligjor i Presidentit

Katrin Treska - Drejtoreshë e Përgjithshme e Çështjeve Ligjore në Presidencë

Bleron Dokle – Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Integritetit në AKEP

Jetmir Braha – Drejtor i Drejtorisë së Autorizimeve në AKEP

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Duke ju kërkuar ndjesë për vonesën fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit për datën 22 janar 2020, i planifikuar për orën 11:00.

Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e dekretit të Presidentit nr. 11414, datë 11.01.2020 “Për kthimin për shqyrtim të ligjit nr. 92/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””. Relator është zoti Arben Pëllumbi. Të ftuar nga institucioni i Presidentit janë zoti Bledar Dervishaj, këshilltar ligjor i Presidentit dhe zonja Katrin Treska, drejtoreshë e Përgjithshme e Çështjeve Ligjore, ndërsa nga AKEP-i janë zoti Bleron Dokle, drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Integritetit dhe zoti Jetmir Braha, drejtor i Drejtorisë së Autorizimeve.

Zoti relator, do ta merrni fjalën për prezantim apo t’ia kalojmë përfaqësuesit të Presidentit?

(Diskutime pa mikrofon)

Të nderuar përfaqësues të institucionit të Presidentit, ju lutem, na parashtroni argumentet tuaja për dekretin e Presidentit lidhur me kthimin e shqyrtimit të ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Bledar Dervishaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Në mënyrë të përmbledhur do t’ju parashtoj arsyetimet e kthimit të ligjit nr. 92/2019 për ndryshimet në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili është pjesë e asaj pakete, të quajtur e të diskutuar në sesionin e mëparshëm parlamentar si “paketa antishpifje”.

Ky ligj ka si qëllim në vetvete reflektimin e atyre ndryshimeve ligjore të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 91 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe lidhet me rregullimin e atyre shërbimeve të publikimeve elektronike për cilat edhe ky ligj është kthyer nga Presidenti i Republikës me një dekret tjetër, dekretin pararendës.

Dispozitat e ligjit nr. 91, i cili nuk është objekt shqyrtimi i komisionit, por janë të lidhur së bashku, jo vetëm që nuk janë në harmoni me Kushtetutën, por bien në kundërshtim me

parimet themelore kushtetuese të një shteti demokratik, të sigurisë juridike dhe proporcionalitetit, dispozitat kushtetuese që mbrojnë të drejtat dhe liritë e medias, të lirisë së shtypit dhe të drejtës së informimit, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe nuk janë në harmoni me standardet e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Ndryshimet e sjella përmes ligjit nr. 92, ligji që shqyrtohet sot, synojnë të realizojnë vënien në ekzekutim të vendimeve që merr qoftë Këshilli i Ankesave, qoftë Bordi i AMA-s përmes kompetencave që u jep ligji tjetër. Konkretisht në nenet 3 dhe 4 të ligjit nr. 92, AKEP-i, apo Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i jepet kompetenca ligjore të zbatojë vendimet e organeve të AMA-s , duke i detyruar njëkohësisht ofruesit e shërbimeve elektronike të zbatojnë këto vendime. AKEP-i është parashikuar të shërbejë kështu si segmenti i fundit i forcës shtrënguese të procesit të marrjes së masës administrative nga organet e AMA-s, masë, e cila në dekretin e mëparshëm është vlerësuar se nuk është objektive, proporcionale dhe transparente, duke u kthyer kështu qartazi në një mjet arbitrar dhe goditës ndaj fjalës së lirë.

Përmes nenit 4 të ligjit nr. 92, AKEP-it i jepet kompetencë që në rastet kur ofruesi i shërbimeve mediedike nuk zbaton urdhrat dhe vendimet e AKEP-it, që lidhen me zbatimin e vendimeve dhe të akteve të AMA-s, i jepet kompetencë që ta ndëshkojë ofruesin elektronik të shërbimeve të publikimit me një masë gjobe prej 1 milion lekë të reja.

Pra, përmes kësaj dispozite të nenit 4 forca shtrënguese që shteti do të ushtrojë është e dyfishtë, një herë me Bordin dhe Këshillin e Ankesave dhe në fund në momentin e ekzekutimit përmes AKEP-it.

Këto dy ligje si pjesë të së njëjtës paketë, pra ligji nr. 91 dhe ligji nr. 92, janë të lidhura pandashmërisht me njëri-tjetrin dhe nëse Kuvendi do të shqyrtojë dhe do të miratojë pjesërisht, plotësisht dekretin nr. 11413 me të cilin është kthyer ligji për mediet elektronike, atëherë patjetër që kjo do të ndikojë edhe në ligjin tjetër, ligjin që po shqyrtohet në këtë komision, nr. 92 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për komunikimet elektronike””.

Në arsyetimin që i është bërë ligjit nr. 91, Presidenti ka parashtruar një sërë argumentesh të domosdoshme për rishikimin e tyre sa i takon edhe sanksioneve financiare, mënyrës së vendimmarrjes, organit që ka të drejtë të marrë vendimin, si dhe mënyrën e ekzekutimit të këtyre sanksioneve apo të masave të tjera ndëshkuese. Mungesa e transparencës në procedurën e vendimmarrjes dhe aplikimi i sanksioneve disproporcionale pa kaluar më parë në shqyrtimin gjyqësor nuk është në balancë mes interesit publik për mbrojtjen nga lajmet e rreme dhe të

drejtës për informim. Nën këtë logjikë edhe nenet 3 dhe 4 të ligjit nr. 92, që është objekt shqyrtimi sot, do të duhet të rivlerësohen së bashku nga ana e Kuvendit me ligjin tjetër nr. 91 për rregullimin e medias.

Sa më sipër nga ana e institucionit të Presidentit të Republikës bëhet edhe një herë thirrje që paketa ligjore të vlerësohet në tërësi me qëllim përfshirjen e rregullave strikte, për ngritjen dhe funksionimin e organeve administrative të pavarura; rivlerësimin e masave administrative të parashikuara qoftë në ligjin nr. 91 dhe ligjin nr. 92; rishikimin e procesit të vlerësimit dhe të masave administrative dhe ekzekutivit, rivlerësimin e efektit të drejtpërdrejtë që do të kenë në përditshmërinë e punës së tyre ndaj shërbyesve të medias elektronike.

Një gjë tjetër që duhet të ketë parasysh komisioni në marrjen në shqyrtim të dekretit është që gjatë këtij rivlerësimi duhet të dëgjohet edhe një herë zëri i organizmave ndërkombëtarë, por mbi të gjitha thirrja më e fundit e zëdhënësës së Komisionit European për Zgjerimin, e cila e vuri theksin te mundësia që i jepet Kuvendit për të reflektuar mbi kthimin e ligjit nisur nga arsyetimi që ka bërë Presidenti i Republikës, duke vënë theksin pikërisht te promovimi i vetërregullimit deri te transparenca e pronësisë së medias, por mbi të gjitha garantimi i një rishikimi të pavarur gjyqësor të ankesave ndaj medieve.

Në deklaratën e Komisionit European ndër të tjera citohet që, nëse parlamenti nuk ndryshon ligjin sipas rekomandimeve të Këshillit të Europës, kjo do të sjellë pasoja edhe në rrugën europiane të vendit. Për më tepër, një lajm, të cilin e kemi evidentuar ditën e djeshme, është fakti që ligji nr. 92 shqyrtohet nga Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, tregtinë dhe Mjedisin, ndërsa ligji nr. 91, nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Konstatojmë se ka një kërkesë drejtuar Komisionit të Venecias, kjo është një falje te Komisioni i Venecias, për të marrë një opinion për ligjin për mediet audiovizive. Sipas Rregullores së Komisionit të Venecias autoritetet që i drejtohen Komisionit të Venecias janë Kuvendi, qeveria dhe Presidenti. Presidenti nuk i është drejtuar, kështu që qeveria ose Kuvendi kanë bërë një kërkesë për ligjin e medias, kështu që patjetër që duhet pritur edhe ky opinion për të atë ligj për të bërë të mundur rregullimin e ndërthurur të dy normave, 91 dhe 92.

Këto ishin arsyt kryesore.

Ju kërkoj falje nëse u zgjata.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Fjalën e ka zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, përpara se të flas në lidhje me kthimin e ligjit me dekret të Presidentit do të doja të dëgjoja edhe AKEP-in se çfarë argumentesh ka gjetur në arsyetimin e Presidentit në lidhje me ligjin nr. 92.

Bleron Dokle – Faleminderit, zoti kryetar!

Sa i përket arsyetimit të institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë lidhur me ligjin nr. 92/2019, më lejoni t’ju sqaroj se AKEP-i bazuar në nenin nr. 15, të ligjit nr. 9918 ekzistues, është institucioni i vetëm rregullator në Republikën e Shqipërisë për respektimin e kufizimeve sa i përket përmbajtjeve të paligjshme që mund të ketë çdo ofrues i shërbimeve të komunikimeve elektronike. Në këtë kuptim ligji nr. 92/2019 përpiqet të rregullojë praktikisht normën ekzistuese të këtij ligji.

Sa i përket nenit 4, të ligjit nr. 92/2019, ligji sqaron që masa administrative nuk do të ndërmerret ndaj medias, e cila ofron shërbime publike dhe elektronike, por ndaj ISP-ve apo ndaj operatorëve të komunikimeve elektronike që e ofrojnë shërbimin ndaj këtyre medieve. Pra, masa administrative do të jepet përkundrejt operatorëve apo ISP-ve që do të ofrojnë shërbimin dhe jo ndaj medias që ofron shërbimin e publikimit elektronik. Kjo masë vjen në përputhje edhe me gjithë nenin 137 të ligjit tonë, për marrjen e masave të gjobave. Në përputhje me këtë nen AKEP-i ka gjithë të drejtën si institucioni i vetëm rregullator në fushën e komunikimeve elektronike të marrë masa administrative ndaj çdo ISP-je, e cila nuk respekton kufizimet e përmbajtjeve të paligjshme.

Si përfaqësues të AKEP-it duhet t’ju sqarojmë që, duke u bazuar në nenin 42 të këtij ligji, nuk shqyrtojmë dot përmbajtjen e një faqeje *online*. Ajo duhet të na serviret si e tillë nga organet kompetente, të cilat vlerësojnë përmbajtjen e ligjshme apo të paligjshme të një kontenti *online*. Pas një vendimi administrativ të çdo organi, i cili është i detyruar me ligj të vlerësojë kontentin. AKEP-i ka të gjithë të drejtën, bazuar edhe në nenin 15, por edhe në ndryshimet ligjore plotësuese që bëhen tashmë për të marrë të gjitha masat, t’i kërkojë ISP-ve respektimin e kufizimit të përmbajtjeve të paligjshme.

Në këtë kontekst, AKEP-i vlerëson në përputhje me frymën e ligjit nr. 99/2018 dhe të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 92/2019.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Fjala për zotin Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

I dëgjova me vëmendje të dyja parashtrimet që bënë edhe përfaqësuesit e Presidencës, edhe të AKEP-it. Në fakt, ashtu sikurse kam parë edhe në dokumentet që i janë paraqitur këtij komisioni, në parashtrimin e Presidencës, në raport me ligjin nr. 92, mungojnë argumente të qenësishme për ta kthyer mbrapsht. Argumentet janë në raport me ligjin nr. 91, i cili shqyrtohet nga një komision tjetër.

Për hir të faktit që ne kemi një procedurë të mirëfilltë parlamentare të konsoliduar, jemi të detyruar që të japim një përgjigje në raport me dekretin e Presidentit, i cili bën fjalë për ligjin nr. 92. Kështu që në këtë kuadër, duke parë që për ligjin nr. 92 nuk kemi argumente, gjykoj që këtë dekret ta rrëzojmë dhe të bëjmë punën tonë sikurse e përcakton procedura parlamentare.

Edhe nga ajo që dëgjova nga AKEP-i, përveç pjesës që ka të bëjë me propagandën në raport me ligjin nr. 91, në raport me ligjin nr. 92 nuk kemi një argumentim të qenësishëm për ta rishqyrtuar apo jo këtë pjesë të vendimmarrjes sonë si Kuvend i Shqipërisë.

Niko Peleshi – Fjala për zotin Gjuzi, më pas, zoti Beqaj.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Dëgjuam edhe zotërinjtë që janë mbrojtësit ligjorë të Presidentit të Republikës dhe mendoj se kanë të drejtë.

Në kundërshtim me kolegun parafolës, kemi shkelje të nenit 85 të Kushtetutës. Presidenti ose ekspertët e tij e cilësojnë këtë, po ta vësh re me kujdes ligjin.

Ndërsa ju të AKEP-it nuk mund të jeni institucioni i vetëm, se këtu institucion i vetëm është Kushtetuta e Republika e Shqipërisë dhe pikërisht neni 85 i saj.

Pra, këmbëngul sërish, që jam kundër këtij ligji. Ky do të quhet ligji i agjitacionit dhe propagandës që kërkon Partia Socialiste për t'u mbyllur gojën medieve dhe njerëzve të lirë në këtë vend.

Ne kemi punuar për këtë vend, e kam shprehur edhe në seancë, po e shpreh edhe përballë kolegëve këtu, që disa nga fytyrat tona kanë dalë në bodec dikur nga sistemi i diktaturës dhe ne nuk duhet të kthejmë një tjetër bodec tashmë për t'iu mbyllur gojën disa të tjerëve. Le të flasin atje ku kanë argument, të thonë të vërtetën dhe aty ku nuk kanë, ka gjykatë administrative dhe gjykatë fakti, ai që është i cenuar t'i çojë proceset në gjykatë dhe të gjejë të drejtën. Ne kërkojmë

shtetin e së drejtës dhe jo shtetin që do të dënojë iksin apo ipsilonin për agjitacion dhe propagandë.

Ky ishte komenti im.

Faleminderit, zoti kryetar!

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Së pari, jo për replikë me kolegun Gjuzi, por neni 85 i Kushtetutës është shumë i thjeshtë: “Presidenti ka të drejtë ta kthejë vetëm një herë”, thotë pika 1. Ne jemi mbledhur sot në respekt të Kushtetutës. Asnjëri nuk po shkel nenin 85 të Kushtetutës.

Pika 2 thotë: “Dekreti për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit”.

Së dyti, mbas Kushtetutës, ne kemi Rregulloren e Kuvendit, e cila na thotë çfarë të bëjmë me shqyrtimin e dekretëve, specifikisht komisioneve përgjegjëse, që në këtë rast jemi ne.

Komisioni përgjegjës, sipas Rregullores së Kuvendit, duhet të merret me ato çfarë ka shpjeguar në relacionin e dekretit që e ka kthyer ligjin mbrapsht. Çfarë na thotë Presidenti në tekst: “Kam kthyer dy ligje, ligjet nr. 91 dhe 92, sepse të dy shkojnë bashkë dhe çdo lloj ndryshimi në ligjin nr. 91, ka efekt të ligji nr. 92”, por nuk na thotë se cili nen i ligjit nr. 92, sipas tij, bie ndesh me këtë, atë dispozitë e të tjera.

Nga sa kam arritur të kuptoj, shqetësimi i Presidentit është që penaltetet vlerësohen disproporcionale, sepse janë vendosur në dy ligje, një herë të ligji i medieve dhe një herë të AKEP-i, por për mendimin tim duhet të kemi parasysh dy momente: në ligjin e medieve penalizohet kontenti i lajmit, sepse atë e shpërndan një ofrues apo prodhues lajmi, por në botën e sotme, në komunikimin elektronik, ky content shpërndahet nëpërmjet një infrastrukture të caktuar. Në këtë rast kemi kontentin dhe karjerin. Përfaqësuesi i AKEP-it e tha qartë se ne merremi me infrastrukturën. Meqenëse shpërndahet nëpërmjet një ISP-je në internet, ky shpërndarësi, edhe sipas nenit 2 të ligjit bazë të AKEP-it, këtë rregullon, prandaj ka dy momente, sepse ne për t’u mbrojtur nga mbipërdorimi, tejpërdorimi apo keqpërdorimi i botës së sotme të komunikimit elektronik, duhet të kemi parasysh që edhe ai që prodhon kontentin, por edhe ai që ka marrë përsipër të bëjë biznes duke e shpërndarë, sepse vërtet një ISP mund të mos marrë fare të ardhura nga një lajm, por në qoftë se është një lajm bombastik, vetëm nga klikimet dhe pastaj i shet ato si të ardhura për reklamë e të tjera. Ky është vlerësimi im i përgjithshëm.

Ndërkohë, konstatoj që në arsyet e rikthimit, Presidenti, sepse ai e ka firmosur, por ata që e kanë punuar, këshilltarët e tij, më duket se janë treguar të pakujdesshëm në atë që kanë shkruar. Shikoni çfarë shkruhet në arsyet e kthimit, faqet e para, 1, 2, 3 dhe 4: “Konstatohet se sipas relacionit të Këshillit të Ministrave dhe raportit të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit në cilësinë e komisionit përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit...”

Ç’punë kemi ne? Ne jemi Komisioni i Veprimtarive Prodhuese. Këto vlejné për ligjin nr. 91. Më vjen keq, por ata që këshillojnë Presidentin, në qoftë si i kanë rënë shkurt relacionit të ligjit nr. 91, duke i futur relacionin e ligjit nr. 92, atëherë i bie që ne s’kemi çfarë diskutojmë këtu për përmbajtjen, se vetë presidenti na ka çuar te ligji nr. 91, që nuk është objekt i kësaj mbledhjeje dhe as objekt i komisionit tonë si komision përgjegjës.

Ndërkohë, edhe kur vijmë te përmbajtja, në arsyetimin e tij vërtet Presidenti jep nenet 3 dhe 4, por çfarë thotë? Thotë që: “Sipas prezantimeve të mësipërme, AKEP-i do të shërbejë si segment fundor i forcës shtrënguese të procesit të marrjes administrative”. Ka zgjidhje me një segment, me disa segmente, ka segment të parë, të ndërmjetëm dhe segment fundor. Pra, unë mendoj se nga ajo çfarë është shprehur në përmbajtjen e arsyetimit të Presidentit nuk ka vend që ne të shqyrtojmë, sepse praktikisht nuk na ka thënë asnjë nen apo paragraf, as fjali se çfarë duhet të bëjmë përveç një vlerësimi të përgjithshëm logjiko-formal që derisa po kthej ligjin nr. 91 dhe aty mund të ndodhin ndryshime, për pasojë, po kthej edhe ligjin nr. 92, që po ndryshoi ligji nr. 91, të reflektohet te ligji nr. 92. Sigurisht, nëse ligji nr. 91 do të kthehet, s’ka nevojë ta thotë Presidenti edhe pa e kthyer dekretin, se do të detyrohem të amendojmë ligjin nr. 92, të jenë të dy në harmoni që të jenë të zbatueshëm, sepse si maxhorancë, jemi të vetëdijshëm që kjo që duam të arrijmë, arrihet me të dy ligjet njëherazi.

Ndërkohë, unë vetë do të kisha dëshiruar që në arsyetimin e tij Presidenti të kishte bashkëndarë shqetësimin e rreziqeve që mund t’i vijnë demokracisë sot në Shqipëri nga lajme jo të vërteta.

Gjithashtu, edhe konstatimin, paragrafin e parafundit të faqes së parë, ku thuhet: “Ka një mungesë transparence të theksuar për publikun”, unë besoj se kjo ka qenë një nga çështjet më të diskutuara dhe më të debatuar në publik e më gjerë.

Në këtë rast edhe pse ai ka dashur të evidentojë në këtë relacion se vetëm transparencë nuk është se nuk ka pasur, sigurisht mund të ketë pasur përdorim më shumë ose më pak të një instrumenti të caktuar transparence, por që për këtë ka pasur mungesë të theksuar transparence

vetëm këtë nuk mund ta themi. Kjo është një histori e diskutuar prej muajsh e muajsh në Shqipëri.

Faleminderit!

Niko Peleshi - E kërkoi fjalën zoti Dervishaj më përpara, pastaj ju, zoti Kujtim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, nuk të ndryshon gjë, por fjala nuk merret me insistim. Zoti Dervishaj pastaj ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë pak e përdor, ti e di që unë jam demokrat.

Zoti Dervishaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'i thuash, nuk po të heq të drejtën e fjalës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk kam qëllim të mbroj as zotin Dervishaj , as ju, por ka një radhë. I kam dhënë fjalën, nuk mund t'ia ndërpres, merreni pas tij!

Besnik Dervishaj – Kushtetuta e përcakton qartë që presidenti e kthen ligjin një herë, por presidenti është pjesë e procesit legjislativ, pra përderisa ligji nuk ka hyrë në fuqi është pjesë e procesit legjislativ. A ka të drejtë ta kthejë? Po, i jepet mundësia nga Kushtetuta të tërheqë vëmendjen e Kuvendit në disa drejtime. Këto dy ligje janë kthyer bashkërisht. Arsyetimet janë të ndërlidhura. Presidenti nuk i drejtohet as Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, as Komisionit të Edukimit dhe Medias, por presidenti i drejtohet Kuvendit, seancës plenare, sepse në fund të ditës do të jetë seanca plenare që përmes votës ose do ta pranojë, ose do ta rrëzojë dekretin e presidentit. Në këtë mënyrë derisa është seanca kuorumi ku vendoset për dekretin, presidenti i drejtohet Kuvendit dhe i thotë se janë të lidhura pandashmërisht të dy ligjet, sepse vërtet u sqaruan nga përfaqësuesit e AKEP-it, institucioni i vetëm do të vendosë për regjistrimin, vendosjen e masave, bllokim. Kësaj çështjeje i paraprin një tjetër më e madhe, që është si do të ekzekutohen vendimet, çfarë mase ndëshkimi do ketë, a do të qëndrojnë ato në fuqi në rrugë gjyqësore ose jo, apo do të jetë gjykata që do të ligjërojë masën shtrënguese, të cilat në këto dy dispozita nuk qëndrojnë. Nëse pranohet dekreti i parë, pashmangshmërisht do të kërkojë edhe ndryshime ligjore edhe në të dytin.

Sa i takon kërkesës për rishikimin e masave, është e përcaktuar edhe sa më sipër me qëllim rivlerësimin e këtij ligji në përputhje me parashikimet kushtetuese, aktet ndërkombëtare, në bindje të Kushtetutës. Në zbatimin e nenit 85, pika 1 të saj, ka vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 92 të vitit 2019, në mënyrë që të rivlerësohet së bashku me ligjin 91/2019 prej të cilit kushtëzohen ndryshimet, me qëllim përfshirjen e rregullave strikte për ngritjen dhe funksionimin e organeve administrative të pavarura, AMA dhe Këshilli i Ankesave dhe vlerësimit të nivelit të masave administrative që përfshihen edhe në këtë ligj. Pra, 1 milionë të reja, pra masave administrative të parashikuara në analizë të realitetit ekonomik në të cilat janë ngritur dhe funksionojnë ofruesit e shërbimit të medias, rishikimin e procesit të vlerësimit dhe marrjes së masave administrative dhe ekzekutimit të tyre, si edhe rivlerësimin e efektit të drejtpërdrejtë që do të kenë në përditshmërinë e punës të ofruesit e shërbimit mediatik. Pra, kur kemi një masë që i jepet tashmë AKEP-it me 1 milion lekë, a është kjo kërkesë e presidentit të rishikohet edhe një herë tek të dyja ligjet së bashku.

Ndjesë, këtë jo për të bërë koment me deputetë, por për ta sqaruar edhe pak më tepër.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Zoti Beqaj, nëse nuk do të ishit djali i një satiristi të madh, unë do të heshtja, por të jesh në këtë moment në krahun e njerëzve që duan t'i mbyllin gojën çdo njeriu që ka të drejtë të thotë një gjë në këtë vend, nuk do të më shkonte në mend, megjithatë, le të shpresojmë në reflektimin tuaj.

Falënderoj zotërinë për një informacion më të detajuar!

Po si harroni ju, deputetë të opozitës, që nuk keni marrë për 6 vjet aderimin drejt BE-së? A nuk e kuptoni që këtu do të jetë një tjetër handicap dhe ju nuk keni për ta marrë as këtë vit. Ne duhet të jemi më të gjerë. Nëse Kryeministri kërkon t'i mbyllë gojën dikujt për të thënë një fjalë dhe ju qorrazi, po e them kështu, jeni dakord me të, edhe kur Presidenti i Republikës është kundër, unë nuk jam me të, e dini shumë mirë, por nuk po behet pengesë, por, respekton Kushtetutën për të ndaluar një gjë që tashmë, siç doli, është, edhe në një komision tjetër ndërkombëtar. Çfarë rreziku ka ky i medias që thotë një lajm të rremë? Ta zëmë se e tha një lajm të rremë. Po ka gjykata, ai që cenohet nga një lajm i rremë, ta çojë në gjykatë dhe mbyllet. Çfarë jemi ne shteti i gjobëvënies? Jo, nuk jemi e nuk duhet të jemi kështu. Unë iu bëj ftesë kolegëve të Partisë Socialiste që të jenë pak më të vëmendshëm në këtë rast, sepse kam merak se

do të kthehemi te ajo “mbyll gojën, hesht, se po kalon punonjësi operativ i lagjes” dhe ai më e pakta nxit sekretarinë e rinisë të të nxjerrë në bodec Kujtim, kujdes. Këtë nuk do ta lëmë. Shumë mirë bën Presidenti, edhe ne do ta çojmë në Gjykatë Kushtetuese. Edhe nëse do të miratohet ligji, nëse do të ketë 3-4 kundërshti të këtij lloji, ju nuk do të keni të drejtë morale të thoni që ne bëmë një ligj të mirë. Prandaj, jemi këtu, keni hapësirën maksimale, ne që jemi, ose të paktën, unë që kam ardhur për të mbajtur rendin kushtetues, parlamentin në këtë 100-vjetor, të mos i përlyjmë këto festa e ngjarje, sepse njerëz para jush nuk deshën ta njohin Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i ranë atij me bojë, me grusht, me kamzhik, disa hoqën rripat. Ishin deputetët tuaj kriminelë që sollën krimin deri në parlament. Mos bëni krim për të ndaluar t’i mbyllim gojën dikujt, jo, le të flasin njerëzit, është shumë mirë kur flasin njerëzit, është transparencë dhe unë jua kërkoj këtë miqësisht juve dhe sidomos relatorit.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Në fakt, ne kemi bërë gjerësisht debat për këtë projektligj, por më shumë se për ligjin nr. 92 kemi bërë për ligjin nr. 91. Më vjen shumë keq që, pavarësisht të gjithë asaj çfarë është thënë, vazhdon po njësoj të bëhet politikë dhe të abuzohet me ligjin nr. 91. Edhe kolegu parafolës abuzoi rëndë me ligjin nr. 91. Më lejoni t’i rikthehem edhe asaj që kemi thënë në këtë komision kur kemi shqyrtuar edhe me ligjin nr. 91 në tagrin e komisionit për dhënie mendimi. Tentohet të normohet një medie e caktuar, e cila ishte jashtë kuadrit ligjor, pra është jashtë të gjithë kuadrit ligjor që normon një biznes. Për sa kohë është një veprimtari, e cila siguron të ardhura duhet të normohet. Kjo ka qenë e para. Sigurisht që kujtdo që i normohet puna do të ketë pakënaqësitë veta dhe është krejtësisht normal reagimi. Por ligji për mediet elektronike është mot a mot ligji për mediet audio dhe audiovizive, i cili ka shumë vite që funksionon në këtë vend. Unë nuk di që kush sot thotë që në televizionet apo radiot shqiptare t’i jetë mbyllur kujt goja, të mos lejohet të flasë, ose më keq ende të ketë frikë se po kalon i plotfuqishmi i lagjes. Prandaj, ju lutem, shumë të mos abuzoni me këtë pjesë, kjo është krejtësisht propagandë, krejtësisht politikë. Ligji vërtet quhet antishpifje, por para se të jetë antishpifje, është deklaram punonjësish, deklaram pagash, deklaram të ardhurash, deklaram burimesh të financimit për këto lloj mediesh, që sot nuk e bëjnë. Nëse kjo pjesë ju djeg unë nuk besoj, të nderuar kolegë, që bëni pjesë tek ata që doni të mbulonin mënyra financimi për disa medie të caktuara.

Niko Peleshi - Po, Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – I nderuar zoti Pëllumbi, me gjithë konsideratën e lartë që kam për ju personalisht, ju sjell në vëmendje që, së pari, nuk kam asnjë lidhje interesi me këtë projektligj. Këtu është vetëm një tallava frike e kryeministrit. Edhe nëse unë bëj politikë këtu, ti duhet ta dish se do të bëj politikë patjetër. Po për çfarë jam unë këtu? Ju lutem, kur të mbaroj unë, mund të flisni ju! Kryetari e ka të drejtën të ndëshkojë te Komisioni i Etikës.

Pra, unë jam këtu të bëj politikën konservatore, të mbroj zërin e medias, të mbroj atë që më duket se ju doni ta cenoni. E ka cenuar për 44 vjet partia juaj kriminale dhe do ta rikthejë prapë atje. Unë nuk them se ti je kriminel.

Niko Peleshi – Ju lutem, zoti Gjuzi, kujdes me fjalorin!

Kujtim Gjuzi – Po. Unë nuk po ju them ju se jeni kriminel, se nuk e di, se po ta dija, nuk kam frikë t’ia them jo ty, por çdokujt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju doni të vendosni sistemin e frikës tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush po abuzon. Po pse më ndërpret? Ti po abuzon. Po abuzon, zotëri!

Niko Peleshi - Zoti Gjuzi, ju po abuzoni me fjalorin, ju lutem!

Kujtim Gjuzi – Në këtë rast unë jam këtu për të bërë politikë dhe për të thënë që nuk i duhet mbyllur goja askujt. Ju doni t’i kontrolloni njerëzit mundësisht edhe sa lugë e pirun kanë në shtëpi. A nuk u kënaqët që në ’90- ën na latë pa bukë, apo harruat.

Tani, edhe kur thotë Europa që këtë ligj shikoje, përmes zëdhënësit, nga ana tjetër lutesh për të hyrë në Europë, edhe kur e çon vetë te Komisioni i Venecies thua nuk e pres atë se do ta marr. Pse të nxitojmë? Le të vijë mendimi i Komisionit të Venecies dhe të jemi më të qetë edhe ne të tjerët. Në lidhje me medien unë nuk hesht. Për intonacionin ju kërkoj ndjesë, por të jemi më të vëmendshëm, 1 vit e gjysmë e ka Kryeministri, nuk ka ku të shkojë, do të ikë, me një telefonatë do të ikë.

Niko Peleshi – Mos dilni jashtë teme, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Po edhe do të dalim.

Zef Shtjefni - Janë dy ligje që shkojnë bashkë. Ne i kemi kaluar në seancë. Unë kam qenë kundër. Jam plotësisht dakord me dekretin e Presidentit. Unë kam një vërejtje për portalet dhe jam plotësisht që ata të kalojnë nëpërmjet një kanali ligjor, që të dihet se cilat dhe çfarë janë

këto portale, sa punonjës kanë e të tjera. Për këtë unë jam dakord. Por nuk bie kurrë dakord që AKEP-i dhe AMA dhe bordet drejtuese të jenë të dominuara vetëm nga njëra anë, ose aty duhet të kishte më shumë gazetarë, juristë, dhe jam dakord me argumentin e këshilltarit ligjor të Presidentit. Unë e mbështes plotësisht, kam votuar kundër këtij dhe do të votoj edhe nesër kundër dhe kurdo që të vijë në seancë. Unë do të votoj pro dekretit të Presidentit të Republikës. Sepse them se i bëjmë më mirë shoqërisë që një ligj që është kaq i përfolur në Shqipëri, le të marrë edhe mendimin e ndërkombëtarëve, megjithëse ju thoni se është marrë mendimi i OSBE-së. OSBE-ja dhe komuniteti ndërkombëtar, në fakt, ka shumë vërejtje, e keni kamufluar me votën në parlament, por unë janë kundër dhe do të jem kundër për këtë.

Niko Peleshi - Faleminderit!

Zoti Bici.

Dritan Bici – Unë mendoj se ky ligj ka qenë i kontestuar nga operatorët që operojnë në tregun e medieve, dhe them se është hera e parë që synohet në këto vite të demokracisë të vihet rregull edhe në këtë sektor. Nuk besoj se ka ligje që synojnë të vendosin rregulla loje që të mos jenë të kontestuar. Kështu që në këtë aspekt unë e shikoj të pa vend kthimin që Presidenti i bën ligjit. Ai ka detyrë kushtetuese që për ato që mendon se e kanë kontestuar ta kthejë, por sikur janë bërë shumë ligje të kthyer nga Presidenti në parlament. Do të thosha që Presidenti ka kaluar në rolin e prefektit me pushtetin vendor. Unë kam qenë disa mandate kryetar bashkie, por nuk na ka kthyer prefekti kaq ligje ndonjëherë këshillit bashkiak. Mbase ky mund të jetë edhe defekt konstitucional i organizimit të shtetit tonë, që e lë presidentin në rolin e një prefekti, shtu këtu edhe situatën në të cilën ndodhemi. Sipas kësaj, Presidenti është i detyruar ta ankimojë në Gjykatën Kushtetuese. Ne kemi disa vite pa Gjykatë Kushtetuese. Në këtë rast i shikoj veprimet e Presidentit në kuadrin e propagandës sepse koha do ta tregojë se do të fillojë funksionimi i Gjykatës Kushtetuese dhe do të shikojmë se sa ligje nga këto që ka kthyer Presidenti do të kalojnë në Gjykatë Kushtetuese për të parë ligjshmërinë, e këtyre ligjeve, cili është i mirë dhe cili është i keq. Nuk dua në asnjë moment t'u jap ndonjë ndihmë zotërinjve të opozitës, sepse dua t'ju kujtoj këtu që ka qenë një kohë që redaksitë e gazetave digjeshin, gazetarët persekutoheshin dhe keqtrajtoheshin nga ana fizike. Ne jemi në një fazë që po synojmë të rregullojmë tregun medietik, sepse edhe kështu nuk mund të vazhdohet. U mor shkas për ta rregulluar këtë treg pas një situate të keqe si tërmeti ku u pa qartë se këto medie mund edhe të

bëjnë veprime kriminale, sepse njerëzit nuk po guxonin të hynin në shtëpi. Kjo krijoi një situatë shumë të keqe.

Prandaj, unë bëj thirrje për përgjegjshmëri. Sepse shikojmë se është një maskarallëk i madh, qarkullojnë lloj-lloj portalesh, të paregjistruara fare. Një person hap nga 7-8 portale dhe fillon e nxjerr lajme. Më rastisi një herë që një iks portal shkruante për një student që në Turqi ishte krenari e studentëve shqiptarë dhe këtë e thoshte një iks burim. Pastaj po ky person e shkruante dhe në një portal tjetër. Pastaj këtë e marrin të gjitha portalet e tjera. Edhe mua më bëhet qejfi që një student të jetë i shkëlqyer, por kur u interesova personalisht se e njihja, më thanë se ka mbetur në disa lëndë, por ky që e shkruante, i biri i tij ishte një punonjës i këtyre portaleve dhe kështu që e shkruante ai dhe hajde merre vesh.

Ka ardhur koha që t'u japim fund mashtrimeve, gënjeshtreve e përfitimeve. Shumë portale janë bërë gjobëvënëse, njëloj si kriminelët për të cilët ne flasim dhe që dalin nga burgjet. Por këto janë më të rrezikshëm, sepse këta veprojnë përditë duke u vendosur gjoba bizneseve, duke kërcënuar politikanë dhe mbahen nuk japin asnjë lloj llogarie nga i kanë të ardhurat, a janë të regjistruar, a paguajnë taksat, në një kohë që ata gazetarë po i përdorin si skllëvër, i mbajnë tërë ditën në dyert e parlamentit dhe të Kryeministrit, që ma ha mendja se rrinë pa bukë ata gazetarë, madje nuk u japin as rroga. as sigurime. Ka ardhur momenti që kush ka këllqe. le ta mbajë, kush ka burime financimi. le ta mbajë, por jo t'i trajtojnë e gjasme t'iu qajnë hallin që po shkelin të drejtat e këtij ose atij dhe dalin pronarët dhe lëshohen se jo na kanë bërë këtë e atë. Ata, së pari, duhet të regjistrohen, të paguajnë sipas ligjeve të shtetit punonjësit e tyre duhet të paguajnë taksat e me radhë, pastaj të vijnë dhe të kërkojnë pretendimet e tyre, që ne, në fund të fundit, jemi të hapur. Ne, si Komision i Veprimtarive Prodhuese, gjejmë shumë anën ekonomike të këtyre ligjeve, ndoshta Komisioni i Medias është më kompetent. Kështu që jam kundër kthimit të këtij ligji dhe për ta dërguar në parlament ashtu siç e kemi dërguar një herë.

Niko Peleshi- Faleminderit, zoti Bici!

Zoti Beqaj, fjala për ju.

Ilir Beqaj- Ju kërkoj ndjesë që po e marr përsëri fjalën, por dua më shumë të përpiqemi të shpjegojmë, edhe për opinionin se për çfarë po diskutojmë.

Unë mendoj se në arsyetimin e Presidentit ka diçka që pa dashje apo qëllimisht nuk është tamam siç thuhet në ligj. Arsyetimi thotë: "Përmes nenit 4 të ligjit nr.92/2019 AKEP-it i jepet

kompetencë që në rast se ofruesi i shërbimeve mediatike nuk zbaton urdhrat dhe vendimet e AKEP-it, që lidhen me zbatimin e vendimeve jo të formës së prerë të bordit të AMA-s e të tjerë, do të ndëshkohet me gjobë në shumën 1 milion lekë”. Kjo nuk është e vërtetë, sepse neni 4 thotë: “Në nenin 37, në fund të kreut V, pas pikës 19, shtohet pika 20”, por në fillim të kreut thuhet: “Me gjobë në vlerën deri në 1 milion”. Pra “Deri në 1 milion” dhe “1 milion” nuk është e njëjta gjë. Kjo nuk mund të kalojë as me një grimë masë, por po flasim për çështje juridike. Është AKEP-i që e vlerëson deri në 1 milion dhe, ndërkohë, nëse për shqetësim të Presidentit kjo vlerë financiare mund të duket e rëndë, më lejoni t’ju citoj se çfarë prej kemi sot për gjobën deri në 1 milion për këto lloj shkeljesh të tjera: “Kontrata e pajtimtarit nuk përmban të gjitha elementet e kërkesës që do të ketë kontrata”. Pra, edhe në qoftë se kontrata e një operatori me një pajtimtar nuk ka gjetur elementet, gjoba prej vitesh në fuqi është deri në 1 milion. Pika 7 nuk u ofron pajtimtarëve nivel të kënaqshëm të faturës së detajuar. Pra, në qoftë se një operator nuk i thotë me detaje si e ka faturën e abonimit mujor një përdorues interneti, AKEP-i e ka në fuqi sot të drejtën ta gjobisë deri në 1 milion dhe Presidenti nuk ka ndjerë ndonjë shqetësim deri sot për këtë rëndesë financiare disproporcionale. Pika 8, “Fatura e detajuar nuk përmban të gjitha të dhënat”, pra edhe në qoftë se fatura nuk ka të gjitha të dhënat e detajuar, sot e kemi në fuqi një gjobë 1 milion, ndërsa, nëse dikush jep një lajm, siç, larg qoftë, e tha dikush në vitin 2003 dhe u turrën shqiptarët e hoqën lekët nga bankat dhe patëm goditje shumë të rëndë ekonomike në vitin 2003, nëse ju kujtohet, sot e jep AKEP-i, AMA i thotë që ta heqë lajmin si përmbajtje, ai e heq përmbajtjen, por në portal është akoma. Neve na rroftë që gazeta, apo ai që prodhoi lajmin thotë që bëra gabim, por në qoftë se lajmi nuk hiqet aty, ku AKEP-i detyron atë që e shpërndan lajmin, efekti është shumë i dëmshëm dhe, për fat të keq, në këtë rast dëmi është publik dhe nuk kemi se kë të padisim në gjykatë dhe se kush është pala. Prandaj na duhet që në këto raste të përdorim elemente administrative dhe prevenues. Ndërkohë, do të doja që, meqenëse përfaqësuesit e presidencës e morën fjalën pas asaj që thashë unë, të kishim dhënë edhe në këtë shpjegim për paragrafin katër të relacionit, ku është më se evidente që kjo ka lidhje me ligjin tjetër dhe jo me këtë ligj.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Fjalën e ka zoti Gjuzi, pastaj zoti Dervishi!

Kujtim Gjuzi - Unë mendoj se debati duhet të vazhdojë. Zoti Beqaj, pse jeni paragjykses në lidhje me Presidentin dhe e fut në kanale të tjera për ato 3-4 argumentet e tjera që dhe? Cili

është argumenti që gjoba deri në 10 milionë lekë të vjetër..., pra, në një farë mënyrë, drejtuesit atje e përzgjedhin vetë se sa ta vendosni gjobën, sipas korrupsionit që shkon atje...

Besnik Dervishaj - Ne nuk jemi gjykatë...

Kujtim Gjuzi – Pse duhet ta marrim kështu? Për këtë kanë reaguar të gjithë, edhe zëdhënësja e OSBE-së.

Faleminderit!

Ilir Beqaj- Kolegë, ajo që doja të thosha është që, nëse ligji thotë se gjoba është deri në 1 milion, Presidenti nuk ka pse ta marrë apriori që çdo gjobë do të shkojë në nivelin maksimal, sepse kështu është ligji.

Së pari, nëse Presidenti thotë në arsyetim se do të ndëshkohet me gjobë në shumën prej 1 milion lekësh, vetë ligji thotë se gjoba është deri në 1 milion.

Së dyti, po e përsëris, në vlerësimin tim, për shkelje më të lehta sesa një marrëdhënie kontrate me një pajtimtar apo vetëm faturën, prej vitesh e kemi gjobën deri në 1 milionë lekë të rinj, apo 10 milionë lekë të vjetër.

Kujtim Gjuzi- Nuk është ky thelbi i çështjes.

Ilir Beqaj- Ky është thelbi, sepse shqetësimi i Presidentit është që rëndesa financiare mund të jetë aq e madhe sa mund ta godasë subjektin. Ky ishte proporcionaliteti dhe disproporcionaliteti midis shkeljes dhe ndëshkimit. Po them që e kemi sot këtë lloj shkalle ndëshkimi edhe për një faturë jo shumë të detajuar.

Niko Peleshi- Zoti Dervishaj, ju lutem sa më shkurt.

Besnik Dervishaj- Shumë shkurt. Dua ta nis fjalën time nga ajo që kërkoi deputeti, paragrafi i katërt i arsyetimit, që duket se ka një pasaktësi të emërtesës së komisionit, por që të dyja komisionet kanë dhënë mendim respektivisht për secilin ligj që është shqyrtuar prej tyre. Mund të ketë gabim ortografik, por e vërteta është që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të dyja komisionet kanë hartuar nga një raport për dhënie mendimi për secilin prej ligjeve që harton secili prej tyre. A e prek kjo thelbin e çështjes?! Jo.

Kalojmë tek argumentet e tjera, të cilat ishin edhe politike, por edhe pak sulmuese ndaj institucionit të Presidentit. Unë po e nis me argumentin që janë kthyer shumë ligje, që e tha njeri nga deputetët. Po, është e vërtetë që në dy vjet janë kthyer 24 ligje e gjysmë veprimtari kushtetuese të Presidentit dhe këtë vit mund të jenë diku rreth 15 ligje. Kjo nuk dëshmon kurrsesi

uljen e nivelit të vlerësimit të ligjit nga institucioni i Presidentit të Republikës, por mund të vlerësohet si ulje e vëmendjes në procesin ligjvënës, sepse ligjet kanë pasur problematika, nuk po flas për këtë të sotmin, të theksuara të nivelit të teknikës legjislative, të hartuar jo me vëmendjen e duhur. A është i detyruar Presidenti të shkojë në Gjykatën Kushtetuese për ato që ka kthyer?! Po, kur shkeljet janë evidente, flagrante dhe bien ndesh me Kushtetutën dhe interesin publik, të gjitha do të shkojnë në Gjykatën Kushtetuese, patjetër!

Për sa i takon vlerësimit të nenit 4, diapazoni deri në 1 milion lekë është pikërisht arsyeja e kthimit. Si vlerësohet masa? Pse pikërisht 1 milion lekë, kur mund të bëhej një shtesë tjetër në këtë projektligj dhe mund të thuash 500 mijë lekë?! Pra, kërkohet vëmendja e Kuvendit që të ulë normën dhe ta rishikojë në përputhje të harmonizuar me ligjin tjetër, asgjë tjetër. Pra, të shikohen në harmoni, sepse, në qoftë se ligji tjetër do të përmirësohet, do të pranohet dekreti dhe automatikisht ky vlerësim që u bë herën e parë shkon në disproporcion. Ky është qëllimi, asgjë tjetër.

Niko Peleshi- Zoti Pëllumbi, fjala për ju.

Arben Pëllumbi- Faleminderit!

Atëherë, në rolin e relatorit të këtij projektligji, duke qenë se argumenti i vetëm që është dhënë nga Presidenti i Republikës, nëse mund ta quajmë të tillë, në raport me ligjin nr.92, është niveli i gjobës prej 1 milion lekësh, edhe ai jo në raport me medien, por në raport me infrastrukturën e shpërndarjes së lajmeve, pra me një biznes të caktuar, i cili nuk është medietik. Nëse ne kemi pranuar që AKEP-i duhet të marrë një rol, është bërë një shtesë në nenin 37 për një gjobë, e cila tashmë është në fuqi dhe rregullon raportet e AKEP-it me ISP-në. Kjo marrëdhënie është, nuk po bëhet sot. Në rast se kjo infrastrukturë nuk i përgjigjet, pra, ajo që tha kolegu Beqaj që, nëse media vetë e heq lajmin, por infrastruktura nuk e heq e lë aty, atëherë AKEP-i duhet të ndërhyjë, sikurse ndërhyjnë edhe në rastet e tjera në raportet që ka me këtë infrastrukturë. Kjo është pjesa që na intereson neve, si komision, ndërsa pjesa tjetër, në raport me mediet, ka të bëjë me ligjin nr.91, nuk shqyrtohet nga ne dhe nuk është pjesë e dekretit të Presidentit në raport me ligjin nr. 92. Kështu që unë propozoj ta hedhim në votim dekretin e Presidentit dhe të vazhdojmë për atë që na takon neve. Neve nuk na takon ligji nr. 91, por do të shqyrtohet nga një komision tjetër.

Niko Peleshi – A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Urdhëroni!

Arlind Çaçani - Faleminderit, zoti kryetar!

Përpara se të përdorni forcën e kartonit, dua të propozoj, meqenëse vetë i jeni drejtuar Komisionit të Venecies, të prisni një herë opinionin dhe më pas mund të shikoni diçka për ta përmirësuar, sepse ligji vërtet ka defekte, ashtu siç janë ngritur edhe nga institucioni i Presidentit, por edhe nga kolegët e opozitës.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Përpara ne kemi dekretin e Presidentit, të cilin e kemi marrë për shqyrtim dhe, për hir të procedurave parlamentare jemi të detyruar që të dalim sot me një gjykim për këtë. Argumentet e Presidentit, në raport me ligjin nr. 92, sikurse i diskutuam, janë pothuajse zero, ose kanë të bëjnë vetëm me masën maksimale të gjobës, e cila nuk është e vendosur sot: ajo aty ka qenë dhe është një raport, që nuk ka lidhje AKEP-i me medien. AKEP-i nuk gjobit asnjë lloj medie. AKEP-i gjobit, nëse lind nevoja, infrastrukturën, të cilën e bën edhe sot për arsye të tjera. Kjo është edhe fusha e veprimtarisë së këtij komisioni. Kështu që në këtë aspekt gjykoj që në rast se ne duam të diskutojmë, mund të vazhdojmë të diskutojmë, por do të vazhdojmë për ligjin nr. 91, jo për ligjin nr. 92, sepse ligji nr. 92 nuk ka argumente. Kështu që të kalojmë në procesin e votimit.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju sjell në vëmendje kolegëve të Partisë Socialiste se e kanë zgjedhur vetë Presidentin, tani në prill bën 3 vjet, e kanë mik Presidentin, sepse ka dalë na strukturat e Partisë Socialiste. Presidenti është bërë i keq për ju vetëm në momentet kur ju ka kthyer ligje në interesin e Kryeministrit dhe të kastës së tij. Prandaj është mirë, sikurse edhe kolegu më i ri në konceptin e moshës, e tha mjaft pjekur, mjaft qetë, pra derisa i jeni drejtuar një komisioni, siç është ai i Venecies, mjaft serioz, derisa reagojnë organizmat e gazetarëve ndërkombëtar dhe organizmat ku ne duam të hyjmë që është BE-ja, tani doni t'ju lutemi juve që t'ju themi: aman, mos e bëni këtë gjë, apo doni që ju të vendosni me forcën e kartonit?! Edhe po vendosët me forcën e kartonit, ju sjell në mendje se 24 mandate i keni të grabitura, të vjedhura. Kështu e doni?! Kështu e bëjmë. Është mirë që në këto raste të mos e godasësh Presidentin e Republikës që nuk ka asnjë argument.

Tani fyen edhe zotërinë, që me shumë argumente të solli në vëmendje, që këto janë disa amendime të bazuara në Kushtetutën e vendit, sepse preket një gjë që është fjala e lirë, atë që me zor e kemi fituar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëre se ka lidhje brendia e ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse më ndërprisni?! Kush e ka mungesën etikës, unë apo ti?

Faleminderit, zoti kryetar!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Ne u dhamë të gjithë kohën e nevojshme diskutimeve që, ashtu siç e tha zoti Pëllumbi, dolën përtej temës, fokusit dhe fushës sonë si komision. E vërteta është se ne kemi vetëm prerje me këtë projektligj që po shqyrtojmë sot, pra dekretin e të cilit po shqyrtojmë sot. Përgjegjësia jonë është e prejardhur në “Paketën antishpifje”. Nuk jemi Komisioni i Medies, kështu që disa diskutime ishin përtej, u morën me thelbin, me çështje që i takojnë medies dhe komisionit përkatës. Ne jemi Komisioni i Veprimtarive Prodhuese. AKEP-i është pjesë e fushës sonë dhe ndaj, ne siç e thashë, pritemi vetëm me projektligjin për komunikimet elektronike.

Kështu që, siç e tha zoti Pëllumbi, relatori në zbatim të detyrimeve tona një dekret të Presidentit ky komision duhet ta shqyrtojë brenda afateve ligjore. Ne jemi brenda këtyre afateve dhe do të hedhim në votë propozimin për ta lënë në fuqi apo për ta rrëzuar këtë dekret. Nuk është vendi, formati, për të folur për thelbin e ligjit, për të cilin ka pasur shumë e shumë diskutime me grupet e interesit dhe me partnerët ndërkombëtarë. Qëllimi nuk është negativ nga asnjë palë, nuk diskutohet dhe as nuk bëhet fjalë, sepse ndoshta zoti Gjuzi e teproi pak, por është e drejta e tij, për të vendosur kontrollin të një kohe të kaluar, por bëhet fjalë për disiplinë. Nuk është një ligj i padiskutuar, është diskutuar shumë, por, gjithsesi, le të ngelemi te detyrimi ynë.

A ka ndonjë propozim për qëndrimin që duhet të mbajmë, në raport me dekretin, të cilin mund ta votojmë?

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe një herë tjetër, përpara se të bëj propozimin, dua të them se ne këtu në komision nuk jemi mbledhur për të gjykuar veprimtarinë e Presidentit të Republikës. Presidenti i Republikës është në drejtën e tij kushtetuese të gjykojë, nëse një ligj e miraton apo e kthen në

parlament, sikurse edhe ne jemi në të drejtën tonë kushtetuese për ta marrë në shqyrtim dekretin e Presidentit dhe për të gjykuar për të. Kështu që, në këtë kuadër, mbështes edhe një herë atë çka thamë të gjithë ne këtu kolegë të maxhorancës dhe propozoj që të vazhdojmë me detyrën tonë në bazë të Rregullores së Kuvendit, pra ta hedhim në votë dekretin e Presidentit dhe unë propozoj që ta rrëzojmë këtë dekret.

Niko Peleshi – Në rregull kemi një propozim nga relatori, zoti Pëllumbi për të rrëzuar dekretin e Presidentit, të cilin duhet ta hedhim në votim.

Kush është dakord me propozimin e zoti Pëllumbi për rrëzimin e dekretit të Presidentit nr. 11414, datë 11.01.2020 “Për kthimin për shqyrtim të ligjit nr. 92/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Kundër? 2 kundër. Abstenim? 1 abstenim.

Atëherë, miratohet propozimi i zoti Pëllumbi për rrëzimin e dekretit të Presidentit.

Faleminderit të gjithëve!

Faleminderit përfaqësuesve të Presidencës!

U lutem anëtarëve të komisionit të mos largohen, sepse do të kemi një mbledhje tjetër pas pak!